



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 52, datë 09.07.2026

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT TË PALLATIT NR. 32, RRUGA “TEODOR RUPI”, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.3, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, SI DHE MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NR. RENDOR 11, ANEKSI 1 I VKB-SË NR.3, DATË 13.01.2023 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË 13 TË 11 SUBJEKTEVE PËRFITUESE, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË MASËN E GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS PROJEKTIT MODEL”

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, VKM-së nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Urdhërit nr.234, datë 18.08.2025, nr.9952 prot., datë 18.08.2025 “Për riformatimin e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit ngritur me Urdhërin nr.164, datë 26.05.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit” i ndryshuar, si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetares së Bashkisë,



KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit të pallatit nr. 32, rruga “Teodor Rupi”, në Njësinë Administrative Nr.3, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, sipas Aneksit 1.
2. Miratimin e ndryshimit të Nr. rendor 11, aneks 1 të VKB-së nr.3, datë 13.01.2023 “Për miratimin e listës së 13 të 11 subjekteve përfituese, të cilët do të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, sipas projektit model”, sipas Aneksit 2.
3. Aneksi nr. 1 dhe nr. 2 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARE

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 10.07.2026



Aneksi 1. “Lista e përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr.32, rruga “Teodor Rupi” në njësinë administrative nr.3, Durrës”.

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHE	Programi
1	Hajredin Tatraku, Sude Tatraku	4	2+1	Rindërtim në të njëjtin truall
2	Asllan Ali, Lindita Ali	4	2+1	Rindërtim në të njëjtin truall

Aneksi 2. “Për miratimin e subjektit përfitues z.Hasan Disha për ndryshimin e programit, duke përfituar nga programi i transferimit në Zonën e Re për Zhvillim Ishëm”.

Nr.	EMËR	MBIEMËR	PËRBËRJA FAMILJARE	STRUKTURA	ZONA E TRANSFERIMIT
1	HASAN	DISHA	5	3+1	ISHËM




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 537/18 prot.

Durrës, më 15 . 07 .2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS
KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 52 datë 09.07.2026 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit të pallatit nr.32, rruga “Teodor Rupi”, në njësinë administrative nr.3, i dëmtuar nga fatkeqsia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, si dhe miratimin e ndryshimit të nr. Rendor 11, aneksi i VKB-së nr.3, datë 13.01.2023 “ Për miratimin e listës së 13 të 11 subjekteve përfituesve, të cilët do të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, sipas projektit model.”

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”i ndryshuar (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

PREFEKTI
ADRIAN GURRA

